

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8286
E premte, 24 prill 2026
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja pas vizitës së Whitakerit në Kosovë: Po avancojmë interesat e përbashkëta të sigurisë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

NË NDERIM TË JETËS DHE VEPRËS SË AKADEMIK REXHEP QOSJES,
24 PRILLI SHPALLET DITË ZIE SHTETËRORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

U SHUA REXHEP QOSJA, U VARROS NGA FAMILJA

FAQE 4-5

Akademiku, shkrimtari dhe kritiku letrar shqiptar, Rexhep Qosja, ka vdekur të enjten në moshën 90-vjeçare. Valjet Rexhepi, nip i tij, tha se Qosja u varros të enjten në një ceremoni private familjare. Në nderim të jetës së Qosjes, në Kosovë më 24 prill do të jetë Ditë Zie. Ngushëllime familjes i kanë shprehur liderët institucionalë në Kosovë e Shqipëri, liderët e partive politike nga të dyja vendet, duke theksuar se veprimtaria e tij letrare, shkencore dhe kombëtare do të mbetet shembull dhe udhërrëfyes për brezat që vijnë



**LIGJVËNËSIT E MIRATOJNË
ME SHUMICË VOTASH
PROJEKTLIGJIN PËR
SIGURIMET SHËNDETËSORE
NË KOSOVË** F.7



**PRESIDENCË
CEREMONIALE, POR
BETEJË E FORTË PËR TË** F.4

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT
FERIZAJ DHE DUKAGJINI
SIGUROJNË FINALEN
E KUPËS SË KOSOVËS F.11

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

HASHIMIN N'GIJOTINË! F.6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



**SHTËPIA E BARDHË THOTË SE
NUK KA "AFAT TË PRERË" PËR
PËRFUNDIMIN E LUFTËS ME
IRANIN** F.2

**KURTI EMËRON AGRON
BAJRAMIN KRYENEGOCIATOR NË
DIALOGUN TEKNIK ME SERBINË**

F.7

EKONOMI



**KUVENDI I KOSOVËS E MIRATON
PROJEKTLIGJIN PËR ÇMIMET
TAVAN MES KUNDËRSHTIMEVE
NGA OPOZITA** F.8

**ENVER PAKASHTICA ZGJEDHET
KRYETAR I SHOQATËS SË
ARTARËVE DHE ARGJENDARËVE
TË KOSOVËS** F.8

SHTËPIA E BARDHË THOTË SE NUK KA 'AFAT TË PRERË' PËR PËRFUNDIMIN E LUFTËS ME IRANIN

WASHINGTON, 23 PRILL - Presidenti amerikan Donald Trump kërkon që Teherani ta japë një përgjigje "të unifikuar" ndaj propozimeve të Shteteve të Bashkuara për përfundimin e luftës së ShBA-së dhe Izraelit me Iranin, dhe ai nuk ka vendosur ndonjë "afat të prerë" tani për tani, tha Shtëpia e Bardhë të mërkurën vonë. Trumpi e zgjati njëanshëm armëpushimin me Iranin, i cili skadonte pikërisht të mërkurën. Presidenti amerikan po i "ofron pak fleksibilitet" regjimit iranian, u tha gazetarëve zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt. Ajo pohoi se ka "shumë përçarje të brendshme" në Teheran. "Kjo është një betejë mes pragmatistëve dhe zyrtarëve të vijës së ashpër në Iran në këtë kohë, dhe presidenti dëshiron përgjigje të unifikuar. Dhe derisa ne po e presim

përgjigjen, e kemi një armëpushim për operacionet ushtarake dhe sulmet kinetike", tha Leavitt. Leavitt shtoi se trysnia ekonomike dhe bllokada detare e ShBA-së mbeten në fuqi. Trumpi e ka bërë një "propozim shumë të fuqishëm" për përfundimin e luftës dhe "nuk ka vendosur ndonjë afat të prerë për ta marrë një propozim nga Irani" si përgjigje, shtoi ajo, pa dhënë hollësi. Paraprakisht, Leavitt i tha "Fox News" se Irani duhet të pranojë ta dorëzojë uraniumin e pasuruar në Shtetet e Bashkuara si pjesë e bisedimeve për t'i dhënë fund luftës. Lufta filloi me sulmet ajrore të ShBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit më 28 shkurt. Pas bisedimeve ballë për ballë në Islamabad më 11 - 12 prill që përfunduan pa marrëveshje, pritej të zhvillohej një raund i ri



këtë javë, por nuk u zhvillua, pasi Irani nuk e konfirmoi pjesëmarrjen dhe negociatorët amerikanë nuk kanë udhëtuar ende për në Pakistan. Komentet e Leavitt erdhën pasi kryetari i Parlamentit iranian, Mohammad Baqer Qalibaf,

përsëriti akuzat e Teheranit se bllokada detare e ShBA-së ndaj Iranit - e vendosur nga Trumpi më 13 prill - përbën shkelje të armëpushimit. Në një postim në X, Qalibaf tha se "rihapja e Ngushticës së Hormuzit është e pamundur

me një shkelje kaq flagrante të armëpushimit". Irani e ka mbyllur praktikisht këtë ngushticë, e cila shërben si rrugë për rreth një të pestën e furnizimit global me naftë dhe gaz natyror të lëngshëm, menjëherë pas fillimit të luftës.

IRANI E AKUZON SHBA-në PËR SHKELJE TË ARMËPUSHIMIT PËRMES BLOKADËS DETARE

TEHRAN, 23 PRILL - Kryenegociatori i Iranit ka kritikuar bllokadën amerikane ndaj porteve iraniane, mes pasigurisë për mundësinë e bisedimeve të reja të paqes me Shtetet e Bashkuara, duke përsëritur pretendimin e Teheranit se kufizimet përbëjnë shkelje të armëpushimit, për të cilin dy shtetet u pajtuan më 7 prill. "Një armëpushim i plotë ka kuptim vetëm nëse nuk shkelet nga bllokada detare dhe pengmarrja e ekonomisë botërore", shkroi kryetari i Parlamentit iranian, Mohammad Baqer Qalibaf, në X më 22 prill. Qalibaf shtoi se "rihapja e Ngushticës së Hormuzit është e pamundur kur ka shkelje kaq



flagrante të armëpushimit". Armëpushimi i arritur më 7 prill ishte dyjavor, por pak orë para se të skadonte, presidenti amerikan, Donald Trump, njoftoi për

zgatjen e tij, por tha se bllokada ndaj porteve iraniane mbetet në fuqi. Armiqtë e Iranit "nuk i arritën qëllimet e tyre përmes agresionit

ushtarak dhe nuk do t'i arrijnë as përmes presionit dhe bullizimit", shkroi ai. "E vetmja rrugë përpara është njohja e të drejtave të popullit iranian". Qalibaf, i cili udhëhoqi delegacionin iranian në bisedimet me ShBA-në në Islamabad në fillim të këtij muaji, të cilat nuk prodhuan ndonjë marrëveshje, nuk bëri asnjë koment të drejtpërdrejtë mbi mundësinë e një raundi të dytë bisedimesh apo mbi vendimin e presidentit amerikan Trump për ta zgjatur armëpushimin dyjavor, që ishte paraparë të skadonte më 22 prill. Presidenti i Iranit, Masud Pezeshkian, e mbështeti këtë qëndrim, duke shkruar në X se

"rrethimi dhe kërcënimet janë pengesat kryesore për negociatën të vërteta. Bota po e sheh hipokrizinë tuaj dhe kontradiktën mes deklaratave dhe veprimeve tuaja". Irani e ka mbyllur në mënyrë efektive Ngushticën e Hormuzit, e cila normalisht shërben si rrugë për kalimin e rreth një të pestës të furnizimit global me naftë dhe gaz të lëngshëm natyror, pak pas fillimit të luftës të ShBA-së dhe Izraelit me Iranin më 28 shkurt. Shtetet e Bashkuara vendosën një bllokadë detare ndaj Iranit më 13 prill, teksa Trumpi ka thënë se ajo do të mbetet në fuqi derisa të arrihet një marrëveshje për përfundimin e luftës.

Dhjetëra të lënduar nga përplasja e dy trenave në Danimarkë

Kopenhagën, 23 prill - Dhjetëra njerëz janë lënduar si pasojë e përplasjes mes dy trenave kokë më kokë pranë kryeqytetit danez, Kopenhagë, të enjten, njoftoi policisë vendëse. Mediet vendëse raportuan se 17 njerëz u lënduan, katër prej tyre rëndë, pas përplasjes së trenave në Gribskov, rreth 40 kilometra në veri të Kopenhagës. Policia e quajti përplasjen "aksident serioz", por një zëdhënës i policisë i tha AFP-së se të gjithë udhëtarët u evakuuan nga trenat. "Dy trenat

u përplasën dhe policia dhe shërbimet emergjente janë mbledhur në numër të madh", tha policia në një komunikatë. Rasti u raportua në orën 6:30 të mëngjesit, sipas zëdhënësit të policisë, Tim Simonsen. "Ishte përplasje kokë më kokë dhe ka të lënduar mes udhëtarëve", tha ai për AFP, pa dhënë hollësi të mëtejshme. Kryetarja e bashkisë së Gribskovit, Trine Egetved, tha në "Facebook" se disa nga të lënduarit u dërguan në spital me helikopter. Pamjet në media treguan

dëmtime në lokomotivat e dy trenave, të cilët ndodheshin mes qyteteve Hillerød dhe Kagerup kur u përplasën. Egetved tha se është "thellësisht e tronditur dhe e shqetësuar" nga aksidenti. "Ky tren përdoret nga shumë banorë të Gribskovit, punëtorë dhe studentë. Shërbimet emergjente po punojnë pa pushim dhe ne po përpiqemi, në nivel qendror, të krijojmë një pasqyrë të qartë të asaj që ndodhi dhe të sigurohemi që të gjithë të marrin ndihmën që u nevojitet", tha ajo.



Danimarka krenohet me standardet e saj të sigurisë, por një aksident treni në vitin 2019 la tetë të vdekur dhe 16 të lënduar. Në gusht të vitit të

kaluar, një tren ekspres u përplas me një kamion bujqësie në një kalim hekurudhor, duke lënë një të vdekur e 27 të lënduar.

U SHUA REXHEP QOSJA, U VARROS NGA FAMILJA

Akademiku, shkrimtari dhe kritiku letrar shqiptar, Rexhep Qosja, ka vdekur të enjten në moshën 90-vjeçare. Valjet Rexhepi, nipi i tij, tha se Qosja u varros të enjten në një ceremoni private familjare. Në nderim të jetës së Qosjes, në Kosovë më 24 prill do të jetë Ditë Zie. Ngushëllime familjes i kanë shprehur liderët institucionalë në Kosovë e Shqipëri, liderët e partive politike nga të dyja vendet, duke theksuar se veprimtaria e tij letrare, shkencore dhe kombëtare do të mbetet shembull dhe udhërrëfyes për brezat që vijnë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 PRILL - Akademiku, shkrimtari dhe kritiku letrar shqiptar, Rexhep Qosja, ka vdekur të enjten në moshën 90-vjeçare, njoftoi familja e tij. Në nderim të jetës së Qosjes, në Kosovë më 24 prill do të jetë ditë zie.

Valjet Rexhepi, nipi i tij, shkroi në "Facebook" se Qosja vdiq dhe u varros të enjten në një ceremoni private familjare. "Njoftojmë se sot, më datë 23.4.2026 është ndarë nga jeta dhe është varrosur Rexhep Qosja. Varrimi u zhvillua në praninë e anëtarëve të ngushtë të familjes. Me dëshirë të të ndjerit, nuk do të organizohet ceremoni pritjeje nga familja. Familja nuk do të marrë pjesë në organizime institucionale. Lusim që privatësia jonë të respektohet dhe të na mundësohet të mbajmë zi në qetësi!", ka shkruar nipi i Qosjes, Valjeti.

Ushtuesja e detyrës e presidentit, Albulena Haxhiu, ka njoftuar se në nderim të jetës dhe veprës së akademik Rexhep Qosjes, 24 prill 2026 shpallet Ditë Zie Shtetërore në Republikën e Kosovës. "Me këtë vendim, shteti ynë shpreh nderimin dhe mirënjohjen për një personalitet që i dha kulturës shqiptare dije, vepër dhe autoritet", ka thënë Haxhiu në vendimin e saj.

Ngushëllime familjes i kanë shprehur liderët institucionalë në Kosovë e Shqipëri, liderët e partive politike nga të dyja vendet. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas ndarjes nga jeta të akademik Rexhep Qosjes. Duke i shprehur ngushëllime familjes Qosja, Rama e ka cilësuar akademikun shqiptar i mirë. "Lamtumirë shqiptar i mirë! Ngushëllime vëllazërore familjes, të afërmve e miqve të profesor Rexhep Qosjes", ka shkruar Rama në "Facebook".

E presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se një akademik i rrallë iku nga Panteoni. "Rexhep Qosja ishte një nga mendjet më të

bukura të kulturës dhe mendimit shqiptar. Ngushëllimet më të sinqerta familjes së tij, të afërmve dhe miqve. Pusho në paqe, Profesor!", ka shkruar Begaj në "Facebook".

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ka thënë se me dhimbje të thellë ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja, një prej intelektualëve të shquar të kombit tonë. Ai ka thënë se veprimtaria e tij letrare, shkencore dhe kombëtare do të mbetet shembull dhe udhërrëfyes për brezat që vijnë.

Ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, ka thënë se sot na la edhe kolosi ynë i fundit intelektual. "Për më shumë se gjysmë shekulli Rexhep Qosja ishte zëri i artikuluar me konsistencë i ndërgjegjes sonë kombëtare. Shkencëtar,

shkrimtar, akademik, profesor, veprimtar dhe kritik - kontributi i tij për studimin e letërsisë shqipe si dhe pasurimi i saj me vepra letrare si autor do të jetojnë gjithmonë. Ai kurrë nuk u mjaftua vetëm me punën shkencore të kabinetit. Gjatë viteve '80, në atë kohë kur ne ishim 'popull i ndaluar', profesor Qosja u shqua me guxim dhe palëkundur për demaskimin e hapur të shtypjes së Serbisë mbi popullin shqiptar", ka shkruar Konjufca në "Facebook".

Edhe kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka ngushëlluar familjen Qosja për vdekjen e akademik Rexhep Qosjes. "E nderuar familje Qosja, me pikëllim të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të akademikut Rexhep Qosja. Humbja e tij është e madhe jo vetëm për familjen tuaj, por edhe për Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar. Si akademik i shquar, ai dha kontribut të jashtëzakonshëm në mendimin shkencor dhe kulturor shqiptar, duke lënë pas një trashëgimi të çmuar dhe të pazëvendësueshme për brezat që vijnë. Si mendimtar i angazhuar në çështjet politike, akademik Rexhep Qosja



kontribuoi edhe në rritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe në përpjekjet për liri e barazi të popullit tonë. Në këto momente të rënda për ju, ju lutem pranoni ngushëllimet e mia më të sinqerta. Kujtimi dhe vepra e akademikut Rexhep Qosja do të mbeten të përherëshme", thuhet në telegramin ngushëllues të Hamzës. Ngushëllime familjes i kanë

shprehur edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj.

Kush ishte Rexhep Qosja?

Qosja lindi më 1936 në Vuthaj të Malit të Zi, ku kreu shkollimin fillor para se të shpërngulej në Kosovë, ku e mbaroi Shkollën Normale në Prishtinë në vitin 1959, ndërsa më 1964 i përfundoi studimet në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës.

Gjatë viteve 1967-'68 specializoi për shkencën e letërsisë në studimet e shkallës së tretë në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Beogradit. Më 1969 u zgjodh bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në vitin 1971 mbrojtë tezën e doktoratës mbi jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit.

Pas doktoratës, më 1972 u zgjodh, një herë bashkëpunëtor i lartë e pastaj këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik si dhe profesor inordinar dhe profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ishte drejtor i Institutit Albanologjik prej vitit 1972 deri

më 1981.

Qosja është autor i mbi tridhjetë librave me studime për letërsinë dhe kritikë letrare, prozë artistike, tregime, romane dhe drama, publicistikë e shkrime polemike. Ai, gjithashtu, ka botuar shumë recensionë, vështrime, artikuj, sprova, trajtesa e studime në revista shkencore e letrare, duke trajtuar në to çështje të veçanta të letërsisë shqipe dhe të krijimtarisë letrare në përgjithësi. Disa punime dhe vepra të tij janë përkthyer në gjuhë të tjera.

Qosja ishte marrë edhe me veprimtari politike. Në periudhën 1998-2000 drejtoi një parti politike në Kosovë. Ai ishte kryetar i Lëvizjes së Bashkuar Demokratike të Kosovës si dhe anëtar i delegacionit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje dhe anëtar i Kryesisë së këtij delegacioni. Po më 2000 shërbeu anëtar i Këshillit Administrativ dhe i Këshillit të Përgjithshëm të Kosovës në kohën që kryeadministrator i Kosovës ishte Bernard Kushner.

Në vitin 2000 kryetari i Republikës së Shqipërisë i dha çmimin "Nderi i Kombit".

Muhamet Mavraj: Lamtumirë, profesor Qosja, i fundit prej rilindësve

Profesori universitar, publicisti dhe botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj i ka dhënë lamtumirë profesorit Rexhep Qosja, duke e cilësuar atë si "të fundit prej rilindësve".

Përmes një postimi në 'Facebook', Mavraj ka shprehur mirënjohjen për përkrahjen që, sipas tij, profesori Qosja ka

dhënë në momentet më të rëndësishme dhe më të vështira.

Më tej, Mavraj është shprehur krenar për raportin dhe bashkëpunimin me profesorin, duke theksuar se dera mes tyre ka mbetur gjithmonë e hapur.

"LAMTUMIRË, profesor Qosja, i fundit prej rilindësve!

Faleminderit për përkrahjen e duhur në kohën e duhur! Faleminderit për përkrahjet e mëdha në ato kohë të vështira! Krenar që nuk ta mbyllem derën kurrë dhe krenar që na e le derën hapur gjithmonë! E lartësove kombin tënd, ndërsa tash është radha e kombit për emrin tënd!", ka shkruar Mavraj.



PRESIDENCË CEREMONIALE, POR BETEJË E FORTË PËR TË

Kosova po hyn në një bllokadë të thellë institucionale, ku mungesa e marrëveshjes për presidentin po ekspozon një krizë më të gjerë të funksionimit politik. Analistët e shohin procesin më shumë si lojë strategjike dhe elektorale sesa si përpjekje reale për zgjidhje. Rreziku i zgjedhjeve të reja po rritet, por pa garanci për stabilitet

PRISHTINË, 23 PRILL - Në kohën kur Kosova përballet me sfida të shumta politike dhe institucionale, gara për pozitën e presidentit ka rikthyer në qendër të vëmendjes përplasjet mes tri forcave kryesore politike.

Vetëm një javë para skadimit të afatit kushtetues për zgjedhjen e kreu të shtetit, vendi mbetet pa një marrëveshje, duke reflektuar jo vetëm mungesë kompromisi, por edhe një luftë më të thellë për ndikim politik. Lëvizja Vetëvendosje (LV), si partia në pushtet, dhe dy subjektet kryesore opozitare, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), vazhdojnë të jenë në pozicione të kundërta lidhur me këtë proces.

Afati kushtetues skadon më 28 prill, por deri tani nuk ka asnjë sinjal për një marrëveshje të mundshme.

Një betejë më shumë për elektoratin sesa për Presidencën

Vëzhguesit e zhvillimeve politike vlerësojnë se, përtej deklaratimeve publike, gara për Presidencën e Kosovës është shndërruar në një instrument për përfitime elektorale. Politologu Dritëro Arifi thotë për Radion Evropa e Lirë se cilado parti që do të arrinte ta siguronte këtë post përmes një marrëveshjeje, do ta paraqiste atë si një fitore të madhe para elektoratit të saj. "Partitë po synojnë që ta tregojnë këtë si fitore. Në këtë rast, absolutisht është Vetëvendosje ajo. Por, edhe dy partitë tjera opozitare (PDK dhe LDK) si një gjysmëfitore, pavarësisht rezultatit të zgjedhjeve", vlerëson ai.

Rezultatet e zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025 e bëjnë këtë betejë edhe më të ndërlikuar: LV-ja ka siguruar mbi 51 për qind të votave dhe 57 deputetë në Kuvend, PDK-ja 20.2 për qind dhe 22 deputetë, ndërsa LDK-ja 13.2 për qind dhe 15 deputetë.

Kjo do të thotë se asnjëra nuk i ka votat e mjaftueshme për zgjedhjen e presidentit pa bashkëpunim ndërpartiak. Sipas Kushtetutës, zgjedhja e presidentit të Kosovës bëhet me 80 vota.

Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk i merr votat e nevojshme në dy rundet e para, atëherë organizohet runda e tretë. E, që ky rund të jetë i suksesshëm, në votim duhet të marrin pjesë së paku 80 deputetë, dhe kandidati që merr së paku 60 vota, zgjidhet president. Në rast të dështimit, vendi shkon në zgjedhje.

Çfarë propozuan partitë?

Deri më tani, LV-ja ka propozuar dy emra për president: Glauk Konjufcën dhe Fatmirë Kollçakun. Por, refuzimi i opozitës për të siguruar kuorumin e nevojshëm e ka detyruar

kryeministrin Albin Kurti, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, të zhvillojë takime me liderët e PDK-së dhe LDK-së.

PDK-ja ka kërkuar që ajo të propozojë kandidatin për president, por është kritikuar nga LVV-ja për mungesë transparence mbi emrat konkretë.

LDK-ja ka kundërshtuar idenë që një parti, në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje, t'i kontrollojë të tria institucionet kryesore të shtetit: Qeverinë, Kuvendin, Presidencën.

Këtë qëndrim, kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e përsëriti edhe pas takimit të fundit që zhvilloi me Kurtin, më 20 prill. Kurti tha se i ka ofruar LDK-së pjesëmarrje në Qeveri ose postin e kryeparlamentarit - ofertë që, sipas tij, u refuzua.

Një ofertë e ngjashme iu bë edhe PDK-së, por lideri i saj, Bedri Hamza, e cilësoi atë si joserioze, duke theksuar se nuk kishte pasur ftesë zyrtare për takim.

Kurti përsëriti më 21 prill se oferta që u është bërë dy partive është "shumë gjeneroze", por, sipas tij, ato nuk janë të interesuara që ta

zhbllokojnë procesin. "Unë nuk po them që opozita është e parëndësishme, përkundrazi, kam bërë ofertë gjeneroze. Kryetari i LDK-së mund të bëhet zëvendëskryeministër, zëvendësi im, dhe përveçse zëvendëskryeministër, njëkohësisht të jetë edhe ministër i Punëve të Jashtme, pra t'i kenë katër ministri edhe të jetë zëvendëskryeministër", tha mes tjerash Kurti.

Të dyja partitë opozitare tashmë kanë bërë të ditur se nuk do të vazhdojnë më bisedimet për këtë çështje.

Radio Evropa e Lirë bëri përpjekje për të kontaktuar përfaqësuesit e të tria partive, por nuk mori përgjigje prej asnjërit.

Strategji politike dhe mungesë sinqeriteti

Analisti Artan Muhaxhiri e sheh këtë përballetje më shumë si një lojë strategjike sesa si përpjekje të sinqertë për të zgjedhur presidentin. Sipas tij, LV-ja nuk ka dhënë sinjale për kompromis, ndërsa opozita është e vetëdijshme për këtë qëndrim. "Në realitet, 'beteja për Presidencën' nuk ka qenë krejtësisht e tillë... të dyja

SHBA PAS VIZITËS SË WHITAKERIT NË KOSOVË: PO AVANCOJME INTERESAT E PËRBASHKËTA TË SIGURISË

PRISHTINË, 23 PRILL - Shtetet e Bashkuara dhe Kosova po vazhdojnë t'i avancojnë "interesat e përbashkëta të sigurisë" dhe ta "forcojnë stabilitetin rajonal". Kështu tha Ambasada Amerikane në Prishtinë në një postim në rrjetet sociale lidhur me përfundimin e vizitës në Kosovë të ambasadorit amerikan në NATO, Matthew Whitaker. "Vizita e tij vuri në pah kontributet në rritje të Kosovës për përpjekjet e ShBA-së për t'i adresuar sfidat globale dhe

rëndësinë e bashkëpunimit tonë përmes KFOR-it dhe përmes Programit për Partneritet të Gardës Kombëtare me Ajovën. Së bashku, ShBA-ja dhe Kosova vazhdojnë t'i avancojnë interesat e përbashkëta të sigurisë dhe forcimit të stabilitetit rajonal", tha Ambasada amerikane. Një ditë më parë Whitaker zhvilloi takime me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, me ushtruesen e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, dhe me komandantin e misionit

të NATO-s në Kosovë, KFOR, gjeneralmajorin Ozkan Ulutash. Ndërkaq në qendër të takimeve, sipas njoftimeve të lëshuara nga zyra e Kurtit, Haxhiut dhe KFOR-it, ishte siguria në Kosovë dhe rajon. Kosova i është bashkuar Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën dhe pritet të dërgojë trupa në territorin palestinez. Kjo forcë është një mekanizëm i krijuar si pjesë e nismës së Bordit të Paqes, i propozuar nga presidenti amerikan Donald Trump për arritjen e paqes në

botë. Kosova është në mesin e pesë shteteve të para - së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë - që janë zotuar për angazhim në këtë mision, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e armëpushimit në Rripin e Gazës. Po ashtu, vendi e konsideron si qenësore aleancën me ShBA-në, shtet që ka kontribuar në pavarësinë dhe shtetndërtimin e Kosovës. Kosova, që është në proces të transformimit të Forcës së

Sigurisë në ushtri, gjithashtu po pajisjet me armë amerikane, teksa është mikpritëse e bazës më të madhe amerikane në Ballkan, Bondsteel. Përveç mbështetjes që ShBA ka dhënë për shndërrimin e FSK-së në ushtri, Uashingtoni kontribuon në trajnimin dhe edukimin e ushtarëve të Kosovës. FSK-ja merr pjesë në trajnime të ndryshme me ushtrinë amerikane dhe ka partneritet të ngushtë me Gardën Kombëtare të shtetit amerikan të Ajovës.



palët janë fokusuar në këtë çështje edhe për qëllime tjera nga ato të proklamuarat. Kryeministri Kurti e ka shfrytëzuar si një mjet për fajësimin e opozitës dhe për përfitime populiste, ndërsa opozita e ka përdorur për të ekspozuar tendencat e tij maksimaliste", vlerëson Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë. Ai, gjithashtu, thekson se partitë opozitare kanë synuar ta paraqesin kryeministrin si të paaftë për të ndërtuar bashkëpunime politike, edhe pse ka një mbështetje të fortë elektorale.

Presidenca si mjet balancimi apo dominimi politik?

Posti i presidentit të Kosovës konsiderohet kryesisht ceremonial, por i ka disa fuqi të rëndësishme që garantohen nga Kushtetua. Presidenti bashkëdrejton politikën e jashtme, nënshkruan marrëveshje

ndërkombëtare, emëron ambasadorë dhe funksionarë të lartë, kryeson Këshillin e Sigurisë dhe ka rol në procesin legjislativ. Për këtë arsye, kontrolli mbi këtë post ka rëndësi strategjike. Sipas Arifit, nëse LV-ja do ta siguronte Presidencën, kjo do të nënkuptonte një dominim pothuajse të plotë institucional. "... e nëse partitë e tjera do ta merrnin këtë post, ato do të përpiqeshin që përmes presidentit të krijonin mekanizma balancues ndaj pushtetit të shumicës, ose të ndërtonin një pozicion që do të sillte më shumë fleksibilitet në politikën e vendit", thotë ai. Vlerësim të njëjtë ndan edhe Muhaxhiri, duke theksuar se qëllimi i LV-së është konsolidimi i pushtetit, ndërsa opozita synon të krijojë një kundërpeshë. Megjithatë, ai shton se çdo përpjekje për një balancë të tillë mbetet e vështirë për t'u realizuar në kushtet aktuale politike. "Opozita mund ta ketë pasur si plan krijimin e

një lloj balancimi të pushteteve. Por, në thelb, edhe nëse një skenar i tillë ka ekzistuar, ai ka qenë jorealit, sepse me kryeministrin Kurti, një qasje e tillë, në këto rrethana, është e pamundur", thotë Muhaxhiri.

Drejt një tjetër cikli zgjedhor?

Blokada për zgjedhjen e presidentit të vendit, aktualisht, duket pothuajse e pazgjidhshme. Sipas Muhaxhirit, mungesa e vullnetit politik dhe paaftësia e partive për të arritur një kompromis racional po e shtynë vendin drejt zgjedhjeve të reja parlamentare. "Është kristal e qartë - nuk ka opsion tjetër përveç zgjedhjeve parlamentare. Në një kohë trazirash të mëdha gjeopolitike, me paqartësi të thella dhe rirreshtime globale, kjo situatë reflekton një dëshirë bizare të politikanëve

tanë", thotë Muhaxhiri. Por, as ky skenar nuk garanton zgjidhje. Arifi shpreh skepticizëm se zgjedhjet e parakohshme mund të prodhojnë stabilitet politik dhe institucional. "Frika ime është se edhe nëse shkohet në zgjedhje, nuk do të ketë zgjidhje afatgjate. Çfarë ndodh nëse rezultatet dalin përafërsisht të njëjta dhe sërish nuk arrihet marrëveshje për presidentin? Atëherë rrezikojmë të mos kemi as Qeveri legjitime dhe as Parlament funksional edhe gjatë këtij viti. Në këtë mënyrë, mund të humbasë edhe viti 2026, njësoj si viti 2025", vlerëson Arifi. Këto paralajmërime mbështeten në përvojën e fundit politike të vendit. Gjatë vitit 2025, Kosova mbajti dy palë zgjedhje parlamentare. Në zgjedhjet e rregullta të 9 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje doli e para me mbi 41 për qind të votave, por dështoi t'i konsolidonte institucionet.

Kjo situatë, pastaj, e çoi vendin në zgjedhje të parakohshme më 28 dhjetor.

Situata institucionale

Mandati i presidentes së deritanishme, Vjosa Osmani, përfundoi më 4 prill. Në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, detyrën e ushtrueses së detyrës së presidentes e mori kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu. Një muaj më herët, më 5 mars, Lëvizja Vetëvendosje propozoi dy kandidatë për këtë post - Glauk Konjufcën dhe Fatmire Kollçakun. Megjithatë, procesi i zgjedhjes nuk u përfundoi për shkak të mungesës së kuorumit në Kuvend. Një ditë më pas Osmani nxori dekret për shpërndarjen e Kuvendit, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi atë, duke e cilësuar pa efekt juridik dhe duke i dhënë Kuvendit afat deri më 28 prill për zgjedhjen e presidentit të ri.

HASHIMIN N'GIJOTINË!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Përsëritja e historisë: Nëse e bëjmë një "skanim" të historisë shqiptare, ta zëmë në 150-vjeçarin e fundit atëherë del se udhëheqësit kryesorë ose janë vrarë nga vetë shqiptarët ose shqiptarët kanë mundësuar vrasjen e tyre.

Marko Boçarin udhëheqësin legjendar të suliotëve e ka vrarë kapedani Lleshi i Zi i Gjonmarkajve, shqiptar gjithashtu.

"Mercenarët" Isa Boletini dhe Haxhi Zeka cilësimi është nga filoserbi Gashi, janë vrarë, i pari nga malazezët e fisit Gjilas të tradhtuar nga francezët dhe shqiptarët ndërsa "mercenari" Haxhi Zeka është vrarë nga Adem Zajmi.

Hasan Prishtina është vrarë nga Isuf Reçi, me urdhër të "mbretit" Zog dhe Nikolla Pashiqit. Luigj Gurakuqi është vrarë nga Baltion Stambolla me urdhër të "mbretit" Zog dhe serbëve.

Avni Rustemi ndonëse për motive krejt të tjera (kombëtare) e vrau Esad Pashë Toptanin.

Enver Hoxha me bandën sllavo-komuniste të Milladin Popoviqit dhe Dushan Mugoshës vrau, dënoi apo dërgoi në internim pjesën më të shëndoshë të patriotëve shqiptarë që kundërshtuan komunizmin dhe mbetjen nën Jugosllavi.

Në Kosovë Fadil Hoxha, Ali Shukriu, Xhevdet Hamza, Mehmet Maliqi - Qorri dhe mbetjet tjera antikombëtare, si rogetarë të OZNA-së e më vonë të UDB-së ndihmuan në arrestimin dhe vrasjen e patriotëve shqiptarë në Kosovë si Gjon Serreçi e Marie Sllaku, Shaban Shala dhe Fazli Grajçevci,

Tahir dhe Nebih Mehaj, Metush Krasniqi dhe Ahmet Haxhiu, Jusuf dhe Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha si Hadrit në Belgjikë.

Me ndihmën e gjeneralit nga Shqipëria Peçi kryen vrasje në masë në Drenicë duke vrarë edhe Shaban Polluzhën. Gjakprishurit komunistë shqiptarë kanë gisht edhe në Masakrën e Tivarit. Për të vazhduar pastaj me qindra e mijëra arrestime dhe dënime të shqiptarëve liridashës në krye Abetaren dhe Frymëzuesin Shqiptarë për Çlirim, Liri, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar, të Papërsëritshmin Bacë Adem Demaçin.

Së fundi, si zgjatje e gjykatave të Serbisë, e votuar dhunshëm në Kuvendin e Kosovës, Gjykata Speciale Raciste në Hagë arrestoi, dënoi ish-luftëtarë të UÇK-së kurse është para marrjes së vendimit për themeluesit e UÇK-së, fituesve të luftës, ndërtuesve të paqes dhe krijuesve të shtetit të Kosovës: Presidentit Hashim Thaçi, kryeparlamentarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli si dhe shefi i GP të LV-së, Rexhep Selimit. Këta katër heronj të luftës dhe të paqes po mbahen në paraburgim plotë 6 vite.

Mallkimi shqiptar: Për Bacën Adem Demaçi thuhej se fare nuk ka qenë në burg por se 30 vite ka qëndruar në hotel "Moska" në Beograd apo në hotele bregdetare. Më shumë është sulmuar dhe vrarë me fjalë dhe shkrime nga gjakprishurit shqipfolës se nga Serbia dhe Jugosllavia. Sidomos gjatë Konferencës së Rambujesë ishte pushkatuar dhe vrarë

mediatikisht nga filojugosllavi dhe filoserbi Veton Surroi, i pëlqyeri nga Sllobodan Millosheviqi për KM të Kosovës dhe Metohisë dhe si udhëheqës i delegacionit shqiptar për Rambuje shkaku i angazhimit të tij për autonominë e Kosovës dhe kundër pavarësisë. Rrjedhimisht Veton Surroi ishte kundër UÇK-së dhe Hashim Thaçit sepse gjithmonë mritzonte nën hijen, autoritetin dhe madhësinë e Shpallësit të Pavarësisë së Kosovës, Hashim Thaçit. Nuk linte rast pa i sulmuar dhe përbuzur përmes deklaratave, shkrimeve, intervistave, konferencave dhe "pordhëve nga Qerreti" që i promovonte në Panairin e Librave në Prishtinë dhe që përktiheshin në gjuhën serbe duke iu dhënë publicitet në Serbi si manifest kundër UÇK-së dhe udhëheqësve të saj. Ekipit të këtij trashëgimtari të mendësisë jugosllave dhe serbe iu bashkuan Vudi Gjymshiti, Rron Gjinovci dhe Shkelzen Gashi duke garuar se kush po shkruan më keq për UÇK-në dhe drejtuesit e saj në përgjithësi dhe Hashim Thaçit në veçanti. Dhe se kush po i pëlqen më shumë trafikantëve të drejtësisë, Ekaterina Trandafilova dhe Jack Smith. Dhe se kush po i hyn më thellë në prapnicë Dik Martit. Përrjashtuar shumë pak rasteve kjo është thelbi i përmbajtjes së modus vivendi dhe modus operandi të LV-së, Albin Kurthit si Cezar i saj si dhe Donika Shvarc si shfrenim patologjik kundër vlerave të luftës, qoftë kundër të burgosurve politikë sikur edhe ndaj ushtarëve të së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Kjo

mendësi patologjike është bartur në të gjitha institucionet që udhëhiqen apo kontrollohen nga Kurthi me rogetarë dhe Dem(j)ona Mihali.

Një deputet me tituj të lartë shkencorë por shkruan lexon si vijues i kursit kundër analfabetizmit shkeli rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë e që sipas mandatit dhe betimit duhet ta mbrojë këtë duke kërkuar dënim të përjetshëm për presidentin Hashim Thaçi dhe të tjerët. Si shprehje e urrejtjes patologjike dhe uvertyrë për fushatë zgjedhore. Çka e tha ky farë deputeti nuk ka të bëjë asgjë me njerëzoren, politiken, kombëtarën dhe moralen. Sidomos nuk ka të bëjë asgjë me tradicionalen dhe zakonoren shqiptare. Nuk ka gjë më të poshtë kur dikush që i ka duart e lidhura, nuk mund të mbrohet sulmohet në mënyrë aq të paskrupullt dhe të ulët se që u sulmua Hashim Thaçi nga deputeti në fjalë, militant i Albin Kurthit, Donika Shvarcit dhe Faton Pecit. "Krenaria" e LV-së! Nuk ka më poshtërsi dhe më ligësi se si u sulmua morali i deputetes Vlora Çitaku, mbesë e dajallarëve të vrarë në masë në Drenicë dhe bijë e intelektualëve shembullorë Sala dhe Shaip Çitaku.

E pabesueshme për një mjedis normal! E pritshme dhe normale për një mjedis ku sundon mediokriteti, antikombëtarizmi, ligësia dhe mungesa e protagonizmit njerëzor, politik, kombëtar, moral dhe intelektual. Pse bëhet kjo: Ata që munguan në proceset ku krijohet historia, sot

duan ta rishkruajnë historinë duke e shembur historinë kombëtare dhe duke e ringjallur historinë jugosllave dhe serbe pjellë e së cilës janë. Po luajnë me zjarr, gjakun po e konsiderojnë ujë, po gërryjnë aty ku dhembë më së shumti dhe ku nuk durohet më.

Hashim Thaçi nuk është as shkruar e as lexues i historisë, është krijuar dhe është vet historia! Bashkë me të tjerët që po mbahen peng, janë dënuar apo që po gjykojnë në Hagë. Bashkë me të gjithë ushtarët e UÇK-së, Heronjtë e Kombit, martirët dhe të burgosurit politikë të të gjitha brezave. Hashim Thaçi është indi ndërlidhës politik dhe kombëtar midis Komandantit Politik Shqiptar Bacë Adem Demaçit dhe Komandantit Ushtarak Legjendar, Adem Jashari. Ismail Qemali dhe Hashim Thaçi janë dy anët e monedhës kombëtare, politike dhe morale për aq kohë sa do të ketë Shqipëri dhe shqiptarë. Na pëlqeu kjo apo nuk na pëlqeu!

Për këtë arsye gjakprishurit që flasin shqip e që mendojnë dhe veprojnë serbisht e duan Thaçin në gijotinë!

Për fund: Nuk e di dhe nuk dua ta paragjykoj vendimin e Gjykatës Speciale Raciste në Hagë por jam i sigurt se pushteti aktual aspak nuk do të gëzohej nëse këta Burra të Kombit do të lirohen. Prandaj është e tëra kjo urrejtje ndaj tyre sepse iu lëkundet pushteti. E them publikisht se në Kosovë janë vetëm dy politikanë që mund ta sfidojnë Albin Kurthin duke e mundur: Hashim Thaçi dhe Përparim Rama.

OEK-u dhe BERZH-i nisin projektin për shërbime digjitale për bizneset

PRISHTINË, 23 PRILL - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka nënshkruar sot marrëveshjen e bashkëpunimit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit të digjitalizimit të plotë të shërbimeve të saj për sektorin privat.

Ky projekt synon transformimin e OEK-ut në një platformë moderne digjitale, duke mundësuar shërbime më të shpejta, më transparente dhe më të qasshme për bizneset brenda

dhe jashtë vendit.

Përmes këtij partneriteti pritet të: zvogëlohet burokracia administrative, kursehet koha e bizneseve, përmirësohet qasja në shërbime, krijohen kushte më të favorshme për investime në Kosovë.

Projekti, gjithashtu, do t'i lehtësojë ndjeshëm proceset për investitorët e huaj që synojnë të investojnë në Republikën e Kosovës.

OEK-u e vlerëson këtë zhvillim si një hap i rëndësishëm drejt modernizimit institucional dhe

forcimit të ekonomisë së vendit.

Në kuadër të projektit do të zhvillohet edhe një platformë digjitale dhe një aplikacion i dedikuar, përmes të cilëve bizneset do të kenë mundësi të marrin shërbime dhe dokumente në formë elektronike.

Oda Ekonomike e Kosovës shpreh mirënjohje për mbështetjen e BERZH-it dhe Qeverisë së Zvicrës për realizimin e këtij projekti strategjik për ekonominë e vendit.



Kurti emëron Agron Bajramin kryenegociator në dialogun teknik me Serbinë

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka emëruar Agron Bajramin në pozitën e kryenegociatorit në dialogun teknik për normalizim të raporteve me Serbinë. Përveç pozitës së re, Bajrami është edhe ambasador i Kosovës në Belgjikë, në kryeqytetin e së cilës, Bruksel, Bashkimi Evropian ndërmjetëson dialogun Kosovë - Serbi. Në muajin shkurt, disa ditë pas votimit të Qeverisë së re të Kosovës, numri dy në ekzekutivin e Kosovës,

njëherësh ministër i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Glauk Konjufca, tha se procesi i dialogut do të udhëhiqet nga kjo ministri.

Mandatin e kaluar qeverisë, në nivel politik, Kosova në dialog është përfaqësuar nga kryeministri Albin Kurti, ndërkaq në nivel kryenegociatorësh nga Besnik Bisilimi.

Vitet e fundit Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar një sërë raundesh të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por takime

të nivelit të lartë politik nuk ka pasur që nga shtatori i vitit 2023.

Atëbotë raundi i fundit i dialogut në nivel të lartë u zhvillua pak ditë para sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, kur një grup i serbëve të armatosur vranë një polic të Kosovës. Kosova e fajëson Serbinë për këtë sulm, por Beogradi mohon se ka gisht në të. Përgjatë viteve të dialogut, Kosova dhe Serbia kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar në terren.



LIGJVËNËSIT E MIRATOJNË ME SHUMICË VOTASH PROJEKTLIGJIN PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË KOSOVË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 PRILL - Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë kaluar me shumicë votash një Projektligj për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor të enjten, një synim i kamotshëm rreth 12-vjeçar për ta sjellë një sigurim, mungesa e të cilit besohet se i ka dëmtonuar shumë qytetarët e vendit.

Projektligji u miratua në lexim të dytë me 80 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, dhe do të bëhet ligj sapo të nënshkruhet nga presidenti i vendit, në këtë rast ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu.

Ai ishte miratuar në parim para rreth dy javëve dhe është mbështetur vazhdimisht edhe nga opozita, e cila, megjithatë, ka kërkuar më shumë sqarime nga qeveria dhe një datë se kur do të fillojnë të zbohen sigurimet shëndetësore për qytetarët.

Projektligji synon mbulimin universal të shërbimeve shëndetësore dhe synon ta përmirësojë shëndetin e mirëqenien, por edhe të parandalojë sëmundje të ndryshme përmes një fondi të sigurimit të detyrueshëm



shëndetësor.

Projektligji përfshin të gjithë popullatën e vendit, synon ofrimin e qasjes universale në shërbime themelore shëndetësore si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Kur do të fillojë zbatimi i ligjit?

Në Kosovë ligji zakonisht hyn në fuqi 15 ditë pasi të publikohet në Gazetën Zyrtare pasi të nënshkruhet nga presidenti i vendit. Por, gjatë një debati para votimit, qeveria u kritikua se nuk ka dhënë ndonjë datë fikse se kur do të fillojnë të përfitojnë qytetarët nga ky ligj. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend

Zemaj, tha se qytetari duhet ta dijë se kur do të fillojë t'i marrë shërbimet nga ky ligj i rëndësishëm. "Ndoshta do të kritikohemi pse e mbështetëm në parim një ligj për të cilin nuk e dimë se kur fillon të zbatohet. Këto janë brenga të përgjithshme, jo personale", tha Zemaj.

Uran Ismaili i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) nënvizoi se "ka frikë" se qytetarët nuk do të mund të përfitojnë së shpejti nga ligji. "Kur do të kemi mundësi ta shohim, a ka pasur planifikim ku thuhet tash, pas një ligji, me këtë afat kohor do të keni sigurime shëndetësore. Unë besoj se edhe pasi të kalojë ky ligj, qytetarët do të përballen me mungesë të sigurimeve shëndetësore", tha

Ismaili.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, nuk qe në gjendje të tregojë se kur do të fillojë zbatimi i plotë i ligjit. "Për dinamikën dhe implementimin e tij, natyrisht se ne do të punojmë ditë e natë dhe përgjegjësia do të na takojë neve, por jam i sigurt se qytetarët shpejt do të bëhen me sigurime shëndetësore", tha Vitia duke iu përgjigjur ligjvënësve opozitarë. Por, profesori i politikave shëndetësore, Liridon Bllaca, i tha Radios Evropa e Lirë ditë më parë deri në funksionimin e plotë të sigurimeve shëndetësore, qytetarët do të paguajnë për disa muaj para se të nisnin t'i marrin shërbimet shëndetësore. Kjo, sipas tij, bëhet për ta mbushur fondin e sigurimeve, ndërsa funksionalizimi i plotë në praktikë i sigurimit shëndetësor do të zgjasë deri në pesë vjet. Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ishte rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese në janar, pasi ajo gjeti se ky ligj ishte miratuar në mënyrë jokushtetuese.

Gjykata tha në vendimin e janarit se Kuvendi e miratoi atë më 5 dhjetor 2024 duke bërë shkeljeve procedurale gjatë procesit ligjvënës. Kjo është një

përpjekje 12-vjeçare për sjelljen e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në vend.

Mungesa e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor besohet se i ka dëmtonuar të gjithë qytetarët e Kosovës, sidomos shtresat e varfra të shoqërisë dhe grupet e cenushme si pensionistët dhe rastet sociale. Aktualisht shërbimet në institucionet publike shëndetësore në Kosovë ofrohen pa pagesë vetëm për kategori të caktuara, si fëmijët, pensionistët apo rastet sociale, ndërsa për të tjerët vlen bashkëpagesa për kujdes shëndetësor.

Shuma e saj varion - nga 1 deri në qindra euro - varësisht nga shërbimi që merr pacienti. Për ato trajtime që nuk realizohen në institucionet publike, përgjegjësinë e mbulimit të kostove e ka Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, i cili menaxhohet nga Ministria e Shëndetësisë. Por procedurat burokratike, derisa pacientët t'i marrin mjetet e nevojshme, zgjasin me javë të tëra, e nganjëherë edhe muaj.

Prandaj, shumë qytetarë detyrohen t'i përballojnë vetë shpenzimet - qoftë në spitale private, qoftë jashtë shtetit. Sigurime shëndetësore kanë vetëm ata që i marrin nga kompanitë private.

Bujar Gashi emërohet drejtor i Shëndetësisë në kryeqytet

PRISHTINË, 23 PRILL - Kryetari Përparim Ram ka bërë me dije se Bujar Gashi është emëruar drejtor i Shëndetësisë në kryeqytet, duke sjellë me vete një përvojë të gjatë profesionale dhe besimin e madh qytetar, si asamblisti më i votuar në zgjedhjet e fundit. "Ky besim është dëshmi e përkushtimit të tij në shërbim publik, dhe jam i bindur se ai do të vazhdojë të

punojë me transparencë dhe vizion për të gjithë qytetarët. Gjithashtu, shpreh mirënjohjen time për drejtorin e deritanishëm, Izet Sadiku. Gjatë mandatit të tij, ai ka dëshmuar jo vetëm profesionalizëm të lartë, por edhe një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj qytetarëve dhe sistemit shëndetësor. Me punën e tij, korrektësinë në vendimmarrje

dhe qasjen gjithmonë njerëzore, ai ka vendosur standarde të larta për drejtimin e këtij sektori. Faleminderit z. Sadiku për përkushtimin dhe profesionalizmin që do të mbeten referencë për të ardhmen. Suksese në angazhimet e ardhshme! Urime z. Gashi për detyrën e re dhe suksese në këtë rrugëtim në shërbim të qytetarëve të Kryeqytetit", ka thënë Rama.



KUVENDI I KOSOVËS E MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR ÇMIMET TAVAN MES KUNDËRSHTIMEVE NGA OPOZITA

PRISHTINË, 23 PRILL - Ligjvënësit në Kosovë e kanë miratuar përfundimisht një Projektligj për Çmimet Tavan të enjten, me gjithë kundërshtimet nga opozita, e cila e akuzoi qeverinë se përmasa e synon ndërhyrje në tregun e lirë.

Projektligji - i njohur zyrtarisht si Projektligji për masat e përkohshme të produkteve themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg - u miratua me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, rreth një javë pasi kishte kaluar në lexim të parë. Për t'u bërë ligj ai duhet të nënshkruhet nga presidenti i vendit, në këtë rast ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu.

Qeveria i ka hedhur poshtë kritikën e opozitës, duke argumentuar se ligji synon të vendosë masa të përkohshme dhe proporcionale për produktet themelore në raste të jashtëzakonshme të çrregullimit të tregut, për t'i mbrojtur qytetarët nga rritja e paarsyeshme dhe e menjëhershme e çmimeve të produkteve bazë.

Ligji i cilëson si produkte themelore: drithërat; miellin; bukën; orizin; makaronat; vajin ushqimor; qumështin dhe produktet e qumështit; ujin; pemët dhe perimet; kripën e kuzhinës; vezët pulës; mishin; sheqerin kristalor; ushqimet bazë për fëmijë; produktet e higjienës personale ku përfshihen: sapuni, detergjenti, shampuni për flokë, letra tualeti,

letrat higjienike, pasta dhe pelenat; lëndët e drurit për djege.

Ligji parasheh gjithashtu themelimin e një bordi me pesë anëtarë, si organin më të lartë dhe përgjegjës për t'u marrë me çështjen e çmimeve tavan, i cili duhet t'i raportojë Kuvendit çdo tre muaj.

Mospajtimet rreth ligjit

Deputetë të tri partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), thanë se nuk e kundërshtojnë nismën e bërjes së një ligji për çmimet tavan, por dolën kundër mënyrës se si qeveria e kryeministrit Albin Kurti e ka përpiluar këtë ligj.

Arben Mustafa, deputet i PDK-së, tha se Projektligji i miratuar të enjten ka "shumë paqartësi" dhe lë hapësirë për ndërhyrje në tregun e lirë. "Nuk është e qartë se në cilat raste do të ndërhyhet në treg për t'i caktuar çmimet maksimale. Në ligj thuhet se do të ndërhyhet në treg në rastet se kur ka rritje të paarsyeshme dhe të menjëhershme të çmimeve. Por, duhet të përcaktohet me ligj se cila është metodologjia për të përcaktuar se çka paraqet rritje të paarsyeshme të çmimit, në të kundërtën lihet hapësirë për arbitraritet për ndërhyrje në treg të lirë", tha Mustafa para ligjvënësve.

Deputetja e LDK-së, Janina Ymeri, tha se "ne nuk e



përkrahim këtë ligj, jo për nismën, por për përmbajtjen dhe formulimin e tij". "Ky ligj mund të jetë i ndikuar nga interesat e tjera partiake, private, personale dhe rrezikon të jetë plotësisht i kapur dhe i ndikuar nga partia në pushtet, pa kontrollim efektiv nga institucionet e tjera shtetërore", theksoi Ymeri.

Besnik Tahiri i AAK-së pretendoi se partia e tij nuk e mbështet ligjin, duke argumentuar se bordi i tij do të "burojë nga qeveria".

Bordi do të përbëhet nga pesë anëtarë, tre anëtarë të jashtëm dhe dy anëtarë të deleguar nga Ministria e Industrisë dhe

Autoriteti i Konkurrencës.

Qeveria i përzgjedh ata dhe ia dërgon Kuvendit të Kosovës për votim me shumicë të thjeshtë të votave prej 61.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari - Lila, i hodhi poshtë akuzat e opozitës duke ngulur këmbë se ligji është i paraparë të aktivizohet vetëm në raste të destabilizimit të tregut. "Ky ligj vlen vetëm për produktet që janë të specifikuar në këtë projektligj, pra produktet e shportës bazë", tha Kusari. Ajo argumentoi se synimi është mbrojtja e kategorive më të cënueshme në lidhje me

ndryshimin e çmimeve dhe se ligji nuk synon përcaktimin e çmimeve për të gjitha produktet, por vetëm për çmimet për listën e produkteve të parapara në ligj.

Ligji për Çmimet Tavan ishte shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2023, kur gjykata kishte theksuar se ai nuk ishte në përputhje me Kushtetutën e vendit. Gjatë mbledhjes së qeverisë më 3 prill, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari - Lila, tha gjatë paraqitjes së projektligjit tha se në hartimin e tij e ka marrë parasysh rekomandimet e Kushtetueses.

MINISTRJA KUSARI-LILA: KOMISIONI PËR EKONOMI REKOMANDON MARRËVESHJEN ME SHTETET E EFTA-S

PRISHTINË, 23 PRILL - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion në Kuvendin e Kosovës ka miratuar disa nisma ligjore të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Sipas ministres, me 7 vota për dhe 1 abstenim është miratuar Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Kosovës dhe shteteve të EFTA, duke e cilësuar këtë si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të integritimit ekonomik në tregjet evropiane me fuqi të



lartë blerëse. Ajo theksoi se kjo marrëveshje krijon mundësi të reja për eksport dhe investime, duke paraparë eliminimin e tarifave doganore për shumicën e produkteve industriale, përmirësimin e qasjes në treg

për produktet bujqësore si dhe rregulla më të qarta për tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, përfshirë sektorë si financat, teknologjia e informacionit dhe turizmi.

Ministrja bëri me dije se tregtia

me vendet e EFTA-s ka shënuar rritje të qëndrueshme, me eksportet që janë rritur nga 77.5 milionë euro në vitin 2023 në mbi 100 milionë euro në vitin 2025, duke përbërë rreth 10 për qind të eksporteve totale të Kosovës, ndërsa ratifikimi i kësaj marrëveshjeje pritet të rrisë më tej praninë e produkteve vendore në tregjet ndërkombëtare dhe të forcojë besimin e investitorëve të huaj. Po ashtu, u bë me dije se Komisioni ka miratuar edhe Protokollin 5, 6 dhe 7 të CEFTA, të cilat mbulojnë tregtinë, shërbimet dhe arbitrazhin, me synim lehtësimin e tregtisë dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal. Në të njëjtën mbledhje është

miratuar edhe Projektligji për Ndërmarrësi dhe Inovacion, i cili synon krijimin e një ekosistemi më të zhvilluar sipërmarrës, duke mbështetur startup-et, idetë inovative dhe transformimin ekonomik drejt një modeli të qëndrueshëm dhe të orientuar nga dijenia.

Ministrja Kusari-Lila theksoi se këto vendime përfaqësojnë hapa konkretë drejt një ekonomie më konkurruese dhe më të integruar, duke krijuar më shumë mundësi për bizneset vendore, dhe shtoi se puna do të vazhdojë me përkushtim për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe zgjerim të mundësive për sektorin privat në Kosovë.

Enver Pakashtica zgjedhet kryetar i Shoqatës së Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës

PRISHTINË, 23 PRILL - Në ambientet e Odës Ekonomike të Kosovës u mbajt mbledhja zgjedhore e Shoqatës së

Artarëve dhe Argjendarëve të Kosovës. Në këtë proces u zgjodh struktura e re drejtuese, me kryetar Enver Pakashtica -

Finesa N.SH.P Oda Ekonomike e Kosovës i ka uruar suksese kryetarit dhe strukturës së re, duke shprehur besimin në

angazhimin e tyre për fuqizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori të rëndësishëm.



KËSHTU UASHINGTONI PO ADOPTON “FORMULËN E VENEZUELËS” PËR TË RRETHUAR REGJIMIN



Uashingtoni do veprojë me anije dhe sulme të shënjestruara. Por Teherani nuk është Karakasi. Për disa, Trump po kërkon një rrugëdalje; për të tjerë, ai është gati ta përshkallëzojë sërish aksionin. Ndoshta duke adoptuar “formulën e Venezuelës”, i inkurajuar nga sukcesi që pati me Nicolás Maduron, edhe pse Teherani nuk mund të krahasohet në asgjë me Karakasin. Sepse bëhet fjalë për kontekste thellësisht të ndryshme dhe gjeografia e favorizon dukshëm Republikën Islamike. Sipas informacioneve të publikuara nga Wall Street Journal, SHBA mund të ndërmarrë sulme të kufizuara ndaj Iranit, një veprim i përqendruar që do të shoqëronte bllokadën detare të shpallur të dielën nga presidenti. Dhe pikërisht këtu qëndron paralelizmi me krizën venezueliane. Pentagoni, përpara se të kapte udhëheqësin, zbatoi një manovër të dyfishtë: disa goditje kundër narkotrafikut, të ndjekura nga ndalimi i

anijeve cisternë, disa prej tyre të lidhura me Iranin. Një presion në rritje, që më pas çoi në inkursionin ajror me helikopterë të komandove të Delta Force. Misioni përfundoi pa shumë probleme, përveç plagosjes, sipas versionit zyrtar, të disa ushtarakëve amerikanë. Ishte vetë presidenti ai që e theksoi gjithashtu paralelizmin me dosjen e Karaibeve: “Nëse ndonjë nga motovedetat e shpejta do t’i afrohet qoftë edhe nga larg bllokadës sonë, do të eliminohet menjëherë, duke përdorur të njëjtën metodë eliminimi që përdorim kundër trafikantëve në anijet në det: e shpejtë dhe brutale.”

Përgatitjet që bën Uashingtoni

Avionët e Forcave Ajrore amerikane mund të godasin më pas bunkerë, raketa dhe instalime përgjatë zonës bregdetare. Por mund të vënë në shënjestër edhe infrastrukturë civile.


Iranianët, sipas ekspertit Hamidreza Azizi, druhen nga vrasje të tjera të shënjestruara të drejtuesve, veçanërisht nga ana e izraelitëve, të cilët nga ana e tyre e mbajnë të lartë nivelin e alarmit për surpriza të mundshme. Qeveria Netanyahu duket e bindur se veprpimet armiqësore do të rifillojnë. Të njëjtin mendim ndan edhe studiuesi rus Andrei Frolov: Shtëpia e Bardhë po përpigjet të fitojë kohë, po grumbullon municione dhe më pas po përgatitet për një ofensivë të re në shkallë të gjerë së bashku me IDF-në. Vëzhguesit që ndjekin lëvizjet në ajër dhe në det kanë sinjalizuar hyrjen në Mesdhe të aeroplanmbajtëses Bush, e treta e mobilizuar nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa mbetet i lartë edhe fluksi i avionëve transportues, të nevojshëm për transferimin e materialeve ose trupave në baza. Ndërkohë, Pentagoni duhet të zbatojë urdhrin e Shtëpisë së Bardhë, duke imponuar kundër-blokadën e tij ndaj lundrimit përmes ngushticës

së Hormuzit. Njësitë po zbatojnë një skemë të parë edhe më herët në rajon gjatë luftës kundër piraterisë dhe trafikut të armëve, dy plagë që nuk janë zhdukur kurrë. Marina mund të urdhërojë ndalimin e një anijeje cisternë ose të një anijeje mallrash; nëse është e nevojshme, dërgon një skuadër në bord për të verifikuar portin e nisjes dhe atë të mbërritjes. Është i mundur edhe përdorimi i helikopterëve, si në rol mbështetës, ashtu edhe të gatshëm për të “shkarkuar” në kuvertë pjesëtarët e forcave speciale. Janë ndërhyrje rutinë, por që nuk e përjashtojnë kurrë plotësisht rrezikun: këtë e kujton vdekja e dy anëtarëve të Navy Seals gjatë një operacioni të ngjashëm të kryer pranë brigjeve të Somalisë në janar 2024.

Kundërmasat nga Irani

Dhe e gjithë kjo ndodh në një kontekst aspak të

qëndrueshëm. Irani e ka cilësuar lëvizjen e Shtëpisë së Bardhë si një akt piraterie, deklarata e shoqëruar me mobilizimin e aparatit të tij në sektorin jugor. Ebrahim Zolfaghari, zëdhënës i Khatam al Anbiya, në praktikë komanda strategjike, ka deklaruar se portet e Gjirit Persik dhe të Detit të Omanit “janë për të gjithë ose për askënd”. Mesazhi është i qartë: do të ketë pasoja për portet e rajonit. Në thelb, Teherani mbetet i rreshtuar me strategjinë e zgjerimit të vazhdueshëm të krizës, duke përfshirë vazhdimisht monarkitë sunite, por edhe duke u imponuar një kosto kujtdo që duhet të përdorë këtë rrugë ujore. Krerët e Republikës Islamike e kishin premtuar këtë në çdo mënyrë në prag të konfliktit, pa taktika dhe pa paqartësitë e tyre tradicionale. Megjithatë, në Uashington nuk deshën t’i dëgjonin. / Guido Olimpio (Corriere della Sera – botal.al)



Arrestohet ish-kryetari i Federatës Maqedonase të Futbollit

SHKUP, 23 PRILL - Ish-kryetari i Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut (FFM), Muhamed Sejдини, është arrestuar të enjten. Sipas raportimeve, Sejдини dyshohet për shpërdorimin e 700 mijë eurove, të cilat UEFA i kishte

ndarë për ndërtimin e një tribune në një stadium në Ohër. "Zyrtarë policorë nga Departamenti për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe të Rëndë dhe Departamenti i Policisë Kriminallistike, në koordinim me Prokurorinë Themelore Publike në Shkup, e

kanë privuar nga liria M. S., për shkak të dyshimeve për kryerjen e veprave penale - përvetësim dhe keqpërdorim", ka njoftuar Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut. Sejдини e kishte marrë drejtimin

e FFM-së në vitin 2018. Nën drejtimin e tij, Maqedonia e Veriut e kishte arritur suksesin më të madh në histori duke u kualifikuar në Euro 2020. Ai ishte larguar nga posti në vitin 2024, pasi i kishte përfunduar mandati.



FERIZAJ DHE DUKAGJINI SIGUROJNË FINALEN E KUPËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, 23 PRILL - Janë përcaktuar finalistët e edicionit të sivjetmë të Kupës së Kosovës në futboll. Në finale do të përballen Ferizaj dhe Dukagjini. Ferizaj ka siguruar kualifikimin falë fitores në ndeshjen e parë ndaj Llapit në Podujevë (2:1), pasi ndeshja e kthimit e zhvilluar në Ferizaj përfundoi pa gola (0:0). Takimi është karakterizuar me tensione, teksa në minutën e 55-të është ndërprerë përleshja për shkak të hedhjes së gjësendeve në

fushë nga shikuesit. Loja ka rifilluar vetëm pasi tribunat janë zbratur, ndërsa deri në fund rezultati ka mbetur i pandryshuar. Për Ferizajn kjo do të jetë paraqitja e tretë në finale të Kupës së Kosovës, pas dy finaleve të humbura në të kaluarën. Në anën tjetër, Dukagjini ka arritur fitore ndaj Ballkanit edhe në ndeshjen e kthimit në Klinë (3:2), duke vultur kualifikimin me rezultat të përgjithshëm 6:2. Ndeshja ka dhuruar spektakël dhe ritëm të lartë, me vendasit

që kanë shënuar përmes Elton Basriut, Mërgim Pefqelit dhe Dienit Isufit. Ballkani, pavarësisht se ka mbetur me një lojtar më pak pas përjashtimit të Albert Dienes, ka arritur të shënojë dy herë me Bleart Tolajn, por kjo nuk ka mjaftuar për ta shmangur eliminimin. Dukagjini do ta luajë finalen e katërt në histori, duke synuar sikurse Ferizaj trofeun e parë në këtë garë. Finalja e Kupës së Kosovës luhet më 21 maj në Prishtinë.



BASHKIMI VAZHDON DOMINIMIN, FITON TITULLIN E KAMPIONIT

PEJË, 23 PRILL - Bashkimi i Prizrenit ka vazhduar dominimin në Superligën e Kosovës në basketboll në konkurrencë të femrave. Basketbollistët e skuadrës prizrenase e fituan titullin e kampionit të mërkurën mbrëma në palestrën "Karagaçi" në Pejë. Në praninë e një numri të madh shikuesish, Bashkimi ka mposhtur Pejën 03 me rezultat 71:61. Për Bashkimin është titulli i katërt rresht dhe i dhjeti gjithsej. Prizrenaset e kanë fituar serinë

finale me rezultatin 4:3. Peja 03 në ndeshjen vendimtare nuk e ka shfrytëzuar terrenin vendas dhe përkrahjen e shikuesve. Bashkimi këtë edicion e ka fituar edhe Kupën e Kosovës dhe Ligën Unike. Ndërkohë Peja 03 mbetet me trofeun e Superkupës. Bashkimi ishte në epërsi thujse gjithë kohën në ndeshjen e shtatë finale. 23:17 në të mirë të Bashkimit përfundoi çereku i parë, ndërsa 19:7 i dyti. Pejanet kanë tentuar të kthehen në pjesën e dytë duke u afruar në rezultat, por mysafiret i kanë rezistuar

presionit duke mbajtur epërsinë deri në fund. Alexis Mead ka udhëhequr Bashkimin me 26 pikë, tetë asistime e katër kërcime. Saranda Daci, ndonëse ka luajtur për kohë të gjatë me katër personale, ka kontribuar me 16 pikë e tetë kërcime. Waggoner Dontavia i kishte 12 pikë e gjashtë kërcime. Paige Powell ishte më e mira te Peja 03 me 21 pikë dhe dhjetë kërcime. Adrienne Godbold i kishte 17 pikë, dhjetë kërcime e katër asistime, por që nuk kanë mjaftuar për t'i dhënë fund dominimit të ekipit prizrenas.


Chelsea shkarkon trajnerin Rosenior

LONDËR, 23 PRILL - Chelsea ka shkarkuar trajnerin Liam Rosenior pas humbjes shkatërruese 3-0 të martën në mbrëmje nga Brighton. Ishte humbja e pestë radhazi e klubit në Ligën Premier, madje pa shënuar gol, seria e tyre më e keqe në 114 vjet. Vendimi vjen tre muaj e gjysmë pasi Roseniori ishte emëruar në krye të Chelseas me një kontratë pesëvjeçare e gjysmë si pasardhës i Enzo

Marescas. "Klubi i Futbollit Chelsea sot i ka dhënë fund kontratës me trajnerin kryesor Liam Rosenior. Në emër të të gjithëve në Chelsea FC, dëshirojmë ta shprehim zyrarisht mirënjohjen tonë për Liam dhe stafin e tij për të gjitha përpjekjet e tyre gjatë kohës që kanë kaluar me klubin. Liam është sjellë gjithmonë me integritetin dhe profesionalizmin më të lartë që nga emërimi i tij në mes të

sezonit. Ky nuk ka qenë një vendim që klubi e ka marrë lehtë, megjithatë rezultatet dhe performancat e fundit kanë rënë nën standardet e nevojshme, me ende shumë për të luajtur këtë sezon. Të gjithë në Chelsea FC i urojnë Liamit suksese në të ardhmen", ka njoftuar Chelsea. I emëruar më 6 janar, Liam Rosenior ishte në krye të Chelseas për 106 ditë.





U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Peperimi" Sh. A a na osnovu rješenja br. protokola 054/26 od 22.04.2026. godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. "Peperimi" Sh. A od 23.04.2026, saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Recepcioner – Čuvar
Broj izvršilaca: 1
Radno vrijeme: 40 sati sedmično
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja
Stručna priprema: Srednja ili osnovna škola
Radno iskustvo: Poželjno šest (6) meseci
Izveštava: Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara
Koeficijent plate: 434.78 Euro Bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Sposobnost za obavljanje posla u punom radnom vremenu bez ograničenja;
- Evidentira posetioce i vodi evidenciju o ulascima i izlascima iz objekta, istovremeno čuva imovinu objekta koji obezbeđuje;
- U slučaju opasnosti odmah obaveštava nadležne osobe;
- Kontroliše prtljag i sumnjive predmete;
- Po potrebi može biti raspoređen i na drugo mesto za recepciju – čuvara;
- Obavezan je koristiti sva propisana sredstva za zaštitu na radu;
- Mora znati koristiti protivpožarna sredstva;
- Ima pristup sigurnosnim kamerama uz prethodnu saglasnost institucije;
- U slučaju požara, evakuacije ili drugih pretnji, upućuje ljude da prate protokole bezbednosti;
- Odgovara za svoj rad Rukovodiocu jedinice recepcionera – čuvara;
- Obavlja i druge zadatke po nalogu menadžmenta preduzeća.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Peperimi" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 25.02.2026 do 11.03.2026.

Okvirni kalendar postupka regrutacije:

- Prethodna provera prijava kandidata: najkasnije do 15.05.2026 godine.
- Rok za žalbu: od 18.05.2026 do 20.05.2026 godine.
- Razmatranje žalbi na prethodnu proveru: najkasnije do 25.05.2026 godine.
- Period polaganja pismenog testa i ocenjivanje kandidata: najkasnije do 01.06.2026 godine.
- Rok za žalbu: od 02.06.2026 do 04.06.2026 godine.
- Razmatranje žalbi na pismeni test: najkasnije do 09.06.2026 godine.

- Period obavljanja usmenog intervjua i ocenjivanje kandidata: najkasnije do 12.06.2026 godine.
- Rok za žalbu: od 15.06.2026 do 18.06.2026 godine.
- Objavljivanje konačnih rezultata o uspešnom kandidatu: najkasnije do 26.06.2026 godine.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L. "Peperimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaje se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

Objašnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

ZAKLJUČAK

NPL "Peperimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Halil Ismajli shpall të pavlefshme dëftesat e vitit të parë, dytë, tretë, katërt dhe diplomën e shkollës së mesme të lartë Teknike "Arkitekt Sinani".
- Halil Ismajli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Musa Hoti" ish shkolla fillore "Meto Bajraktari".
- Rina Nazifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të lartë të mjekësisë "Dr. Xheladin Deda".
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 marsi" Prizren.
- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfm u " Zef Lush Marku" Velezhe.
- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfm u " Zef Lush Marku" Velezhe.
- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.
- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me numër 200102037.
- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Silvira Tomazini" gjimnazi "Frang Bardhi" Mitrovicë.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 04-26

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në **adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për Shërbime të Transportit Ajror

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **30/04/2026 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **05/05/2026 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **05/05/2026 ora 12:00.**

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “AUTO E XH & E H” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812224575 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa “AUTO E XH & E H” D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812224575 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “AUTO E XH & E H” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812224575 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ricon” SH.P.K. pronar Blerian Ademi me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812337873 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa “Ricon” D.O.O. Blerian Ademi Vushtrri donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812337873 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ricon” L.L.C. with owner Blerian Ademi with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812337873 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Pozita:	Auditor/e i/e Lartë i/e Teknologjisë Informative
Grada e pozitës:	A03
Kohëzgjatja e punësimit:	me afat të pacaktuar
Njësia:	Njësia e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (NJATI)
I raporton:	Udhëheqësit të NJATI

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin/en merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Në cilësinë e udhëheqësit/es të/së ekipit, kryen auditime të teknologjisë informative, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raportet, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët tjerë të njësies apo funksionit të Auditimit të Brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit të teknologjisë informative dhe teknologjisë informative sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kodin e Etikës, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilat rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm;
- Kryen shqyrtime të pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante), me theks të veçantë ato të TI-së, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm të teknologjisë informative, monitoron performancën, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transaksionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Kur kërkohet nga Udhëheqësi/ja i/e NJATI apo Shefi/ja i/e Auditimit të Brendshëm, jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Udhëheqësit/es të/së Njësies së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, apo Shefit/es të/së Auditimit të Brendshëm;
- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të teknologjisë informative, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të stafit të Njësies së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit apo Auditimit të Brendshëm në përgjithësi, në rastet kur kërkohet;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, shkencave kompjuterike, shkencave teknike, shkencave matematiko-natyrore, apo relevante;
- Certifikatë profesionale në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative ose Teknologjisë Informative (certifikimet si CISA, ISO/IEC 27001, COBIT ose NIST paraqesin përparësi).

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e auditimit të teknologjisë informative apo në fushën e teknologjisë informative.

Kërkesat e posaçme:

- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioritetëve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohuri mbi kornizën dhe standardet si COBIT, NIST, CIS, ISO 27001, ITIL, etj;
- Njohuri mbi fushat e ndryshme të teknologjisë informative si: zhvillimi i softuerit, sistemet operative, menaxhimi i data bazës dhe rrjeta;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku tre (3) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku tre (3) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **12 maj 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Pozicija:	Viši/a revizor/ka informacionih tehnologija
Stepen pozicije:	A03
Trajanje zaposlenja:	Na neodređeno vreme
Jedinica:	Jedinica za reviziju informacionih tehnologija (JRIT)
Izveštava:	Rukovodiocu JRIT-a

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- U saradnji sa rukovodiocem učestvuje u izradi plana revizije i usvaja planove rada i rokove za sprovođenje revizija i drugih relevantnih usluga;
- U svojstvu rukovodioca tima, sprovodi revizije informacionih tehnologija, obavlja intervju sa osobljem (kadrovim), prima i analizira relevantnu dokumentaciju u skladu sa ciljevima CBK-a i u skladu sa Zakonom o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statutom interne revizije, Priručnikom za internu reviziju itd.;
- Sprovodi redovne revizije ili na zahtev, o efikasnom korišćenju resursa CBK-a, izrađuje nacrt izveštaja, diskutuje o rezultatima sa rukovodiocem i drugim revizorima jedinice ili o funkcijama interne revizije i izrađuje konačne izveštaje o njegovom/njenom angazovanju;
- Aktivno učestvuje u diskusijama sa internim revizorima, finalizuje dosije revizije i prati sprovođenje preporuka koje je dala interna revizija;
- Daje savete o pitanjima revizije informacionih tehnologija i informacionim tehnologijama, po potrebi;
- Sprovodi Zakon o Centralnoj banci Republike Kosovo, Statut interne revizije, Priručnik za internu reviziju, Etički kodeks, kao i sve ostale akte kojima se uređuje delokrug interne revizije;
- Sprovodi nezavisne revizije postojećih ili predloženih sistema u svim subjektima CBK-a (odeljenja, odseci, kao i druge relevantne oblasti), sa posebnim naglaskom na IT, dajući preporuke za njihovo poboljšanje;
- Ocenjuje efikasnost i delotvornost svih važnih sistema interne kontrole informacionih tehnologija, prati učinak, dajući preporuke za unapređenje funkcionisanja sistema interne kontrole;
- Testira rad sistema u CBK-u, pouzdanost i potpunost informacija, kao i transakcije koje su generisane u skladu sa zakonima, politikama, procedurama, planovima i uredbama kojima se CBK rukovodi;
- Na zahtev rukovodioca JRIT-a ili šefa/ice interne revizije, daje doprinos tokom pripreme godišnjeg plana interne revizije;
- Obavlja administrativne poslove prema potrebama rukovodioca Jedinice za reviziju informacionih tehnologija, ili šefa/ice interne revizije;
- Da ima spremnost da učestvuje u relevantnim obukama za interne revizije informacionih tehnologija, kao i da pruža odgovarajuću pomoć preostalim delu osoblja Jedinice za reviziju informacionih tehnologija ili interne revizije, generalno, kada je to potrebno;
- Da dokaže da on/ona razvija njegove/njene veštine u korist Centralne banke i interne revizije, u njenom okviru.

Potrebno akademsko znanje i stručna sprema:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, računarskih nauka, tehničkih nauka, prirodnih-matematičkih nauka, ili relevantne njima;
- Stručni sertifikat u oblasti revizije informacionih tehnologija ili u oblasti informacionih tehnologija (sertifikati kao što su CISA, ISO/IEC 27001, COBIT ili NIST predstavljaju prednost).

Potrebno stručno iskustvo:

- Da ima najmanje tri (3) godine stručnog iskustva u oblasti revizije informacionih tehnologija ili u oblasti informacionih tehnologija.

Posebni zahtevi:

- Odlučne organizacione i veštine planiranja i upravljanja vremenom;
- Odlučne međuljudske i komunikacione veštine, kao i veštine u rešavanju konflikata;
- Tačnost, pažnja u detaljima i osetljivost na prioritete;
- Odlučno poznavanje korišćenja softverskih aplikacija paketa MS Office;
- Da poseduje tačno znanje albanskog i/ili srpskog jezika, usmeno i pisano.
- Znanje o okviru i standardima kao što su COBIT, NIST, CIS, ISO 27001, ITIL, itd.;
- Poznavanje različitih oblasti informacionih tehnologija kao što su: razvoj softvera, operativni sistemi, upravljanje bazama podataka i mreža;
- Znanje engleskog jezika je prednost.
- Da ima veštine da radi efikasno u multietničkom i multikulturalnom okruženju.

Svi kandidati treba da dostave sledeća dokumenta:

- Prijave koje nisu u potpunosti i ispravno popunjene na **Zvanični obrazac CBK-a tokom onlajn podnošenja prijave**, neće biti razmatrane i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati treba da **prilože propratno (motivaciono) pismo**, koje treba da bude adresirano i pripremljeno **posebno za poziciju za koju podnose prijavu**; u suprotnom, prijava neće biti razmatrana;
- Dokazi o radnom iskustvu, koji pokrivaju najmanje tri (3) godine radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti kojima se dokazuje rad na toj poziciji i radno iskustvo, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka).
- Izveštaj iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta) za relevantni period, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva**, ili, u slučajevima kada izveštaj iz Trusta nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu iz Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo treba da budu službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja prijave:

- Rok za podnošenje prijave je 12. maj 2026.
- Podnošenje prijave može se vršiti onlajn (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a. Ostali oblici podnošenja prijave neće biti razmatrani.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

